

LIGJI NR. 06/L - 119

PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 2004/22 PËR KINEMATOGRAFINË

Kuvendi i Republikës së Kosovës,

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton:

**LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 2004/22 PËR
KINEMATOGRAFINË**

**Neni 1
Qëllimi**

Qëllimi i këtij ligji është ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit Nr.2004/22 për Kinematografinë.

Neni 2

Neni 55 i ligjit bazik, ndryshohet si në vijim:

Neni 55

Me gjobë prej dhjetmijë (10.000) euro deri në njëzetëmijë (20.000) euro, gjobitet për kundërvajtje distributori, përkatësisht pronari ose qiramarrësi i një kinemaje që e ndryshon qëllimin e veprimtarisë së kinemasë pa pëlqimin e QKK sipas nenit 8 të këtij Ligji.

Neni 3

Neni 56 i ligjit bazik, ndryshohet si në vijim:

Neni 56

1. Me gjobë prej pesëqind (500) euro deri në dhjetmijë (10.000) euro gjobitet për kundërvajtje shfaqësi, përkatësisht distributori:

1.1. Që shfaqë një film të pa pajisur me lejen për shfaqje publike sipas nenit 9 të këtij ligji ose që i është refuzuar dhënia e lejes sipas nenit 10 paragrafi 2 të këtij Ligji;

1.2. Që lejon të miturëve nën katërbëdhjetë (14) vjeç të kenë qasje në kinema kur filmi është i pajisur me lejen e kategorisë "B", ose të miturëve nën tetëmbëdhjetë (18) vjeç sipas nenit 10, paragrafi 1, pika (b) dhe (c) të këtij Ligji;

1.3. Që shfaqë një film para orës 22:00 me përmbajtje në kuptim të nenit 10 paragrafi 3 të këtij Ligji.

Neni 4

Neni 57 i ligjit bazik ndryshohet si në vijim:

Neni 57

Me gjobë prej dyqind (200) euro deri në pesëmijë (5.000) euro gjobitet për kundërvajtje, producenti që nuk vepron sipas nenit 54 paragrafi 1 të këtij ligji.

Neni 5

Neni 58 i ligjit bazik ndryshohet si në vijim:

Neni 58

Me gjobë prej pesëqind (500) euro deri në dymijë (2.000) euro gjobitet për kundërvajtje anëtar i jurisë vlerësuese që ka fshehur informacionin ose faktin që paraqet pengesë për të qenë anëtar i jurisë vlerësuese ose që ka marrë pjesë në mbledhjen e jurisë vlerësuese përkundër pengesave në nenin 43 paragrafi 6 të këtij ligji.

Neni 6

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 06/L - 119
30 maj 2019

Shpallur me dekretin Nr. DL-125-2019, datë 21.06.2019 nga Presidenti i Republikës së Kosovës Hashim Thaçi